



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE PRISHTINE

Numri i lëndës: 2022:178443

Datë: 21.05.2024

Numri i dokumentit: 05716216

A.nr.2112/2022

GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË, Departamenti për Çështje Administrative, me gjyqtaren Luljeta Maxhuni dhe me bashkëpunëtoren profesionale Donjeta Nikolla, në konfliktin administrativ të paditësit, nga fshati, i cili përfaqësohet nga avokati me autorizim, kundër të paditurave, Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës në Prishtinë dhe Ministria e Punëve të Brendshme – Policia e Kosovës në Prishtinë, për shkak të anulimit të vendimit, në seancën e shqyrtimit kryesor publik, të mbajtur në prani të përfaqësuesit të palës paditëse dhe në mungesë të palëve të paditura, me datë 15.04.2024 merr këtë,

A K T G J Y K I M

I. APROVOHET si e bazuar kërkesëpadia e paditësit nga fshati dhe **ANULOHET** vendimi me numër A.nr.693/2021 i datës 05.08.2022 i të paditurit, Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës.

II. DETYROHET e paditura e dytë, Ministria e Punëve të Brendshme-Policia e Kosovës në Prishtinë, që paditësit t’ia paguaj shumat si në vijim: në emër të shpërblimit të pagës së trembëdhjetë për fund vitet 2018, 2019, 2020, 2021 dhe 2022 duke u bazuar në pagën mujore prej 444.08 € për (5) pesë vite e në total shumën prej 2,220.4 euro (dy mijë e dyqind e njëzet euro e katër cent), në emër të shtesave për kualifikim shkollor 0.5% në bazë të diplomës universitare për vitet 2018, 2019, 2020, 2021 dhe 2022 sipas pagës mujore prej 444.08 euro në muaj për (5) vite, që të gjitha këto me kamatë ligjore prej 8% nga dita e paraqitjes së kërkesës për kompensim pranë të paditurës data 22 Korrik 2021 e deri në pagesën definitive, të gjitha këto në afat prej 15 ditësh, nga dita e plotfuqishmërisë së këtij Aktgjykimi, e nën kërcënim të përmbarimit të dhunshëm.

III. Ky Aktgjykim i zëvendëson aktet e anuluar dhe ka karakter detyrues.

A r s y e t i m

Shqyrtimi kryesor në këtë çështje juridike është mbajtur në kuptim të nenit 41 të LKA-së, në prani të përfaqësuesit të palës paditëse dhe në mungesë të palëve të paditura të ftuara në mënyrë të rregullt.

I autorizuari i paditësit me padinë e parashtruar në këtë gjykatë me datën 21.02.2022 dhe në seancën e shqyrtimit kryesor të datës 15.04.2024 ka deklaruar se, e kundërshton në tërësi vendimin kontestues të datës 05.08.2022 me numer A.nr.693/2021 dhe aktet e të paditurës së dytë si të pa bazuara në dispozita ligjore. Mbetet pjesërisht pranë kërkesëpadisë së paditësit të ushtruar pranë kësaj gjykate. I njëjti shton se sa i përket kompensimit për pagën e 13- të për vitet 2018-2019-2020-2021, e paraqet kërkesën për kompensim në pagën e 13-të edhe për vitin 2022, si dhe shtesat në pagë prej 0.5 % dhe kualifikimin shkollor për gradën Bachelor, kurse është tërhequr nga pjesa tjetër e kërkesëpadisë për shujtat ditore për vitet 2018-2019-2020-2021.

I njëjti përmes parashtrësës për precizimin e kërkesëpadisë ka kërkuar nga gjykata që të detyrohet e paditura Policia e Kosovës që ti kompensoj në mënyrë retroaktive paditësit, shpërblimin në Pagë – Paga e 13-të për vitet 2018, 2019, 2020, 2021 dhe 2022, duke u bazuar në pagën mujore prej 444.08 Euro, që i bie 2.220.4 Euro (dymijë e dyqind e njëzetë euro e katër cent) dhe Shtesa në Pagë për Kualifikimin shkollor për vitet e lartcekura, bazuar në pagën mujore prej 444.08 Euro, sipas llogaritjes mujore i bie për 60 muaj, që është shuma e përgjithshme prej 133.02 Euro (njëqind e tridhjetë e tri euro e dy cent). Të gjitha këto me kamatë ligjore prej 8% nga data e arritjes për pagesë e deri në pagesën definitive në afat prej 15 dite nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.

E paditura KPMSHCK me përgjigje në padi të parashtruar në këtë gjykatë me datën 12.01.2024, ka theksuar se, i konteston pretendimet e palës paditëse si të pa bazuara dhe i propozon gjykatës që të merr Aktgjykim me të cilin refuzohet padia e paditësit si e pa bazuar dhe vërtetohet vendimi me numër A.nr.693/2021 i datës 05.08.2022 i Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës si i bazuar në ligj, është vendim i drejtë.

E paditura MPB – Policia e Kosovës, respektivisht Avokatura Shtetërore me përgjigje në padi të parashtruar në këtë gjykatë me datën 14.02.2024, i propozon gjykatës që padia e paditësit të

hedhet poshtë si e palejuar, me arsyetimin se gjykata në konflikt administrativ vendosë për ligjshmërinë e akteve përfundimtare administrative.

Gjykata në seancën e shqyrtimit kryesor të mbajtur me datë 15.04.2024, ka bërë administrimin e provave dhe atë: formulari për paditësin i dt.14.01.2022; raporti 10.01.2022; emali i dt.22.07.2021; 27.07.2021; formulari për vlerësim 18.01.2021; i dt.19.01.202; vlerësimi i dt. 06.01.2020; formulari 04.01.2019; Shkresa e dt. 30.04.2021; njoftimi i dt.06.09.2021; ankesa e dt. 27.07.2021; Kërkesa 22.07.2021; përgjigja e dt. 23.07.2021; Aktgjykimi 01.07.2022 numër 2324/2021; vendimi i dt.05.08.2022 me numër 693/2021; vijueshmëria numër 1135; formulari 14.01.2022; diploma e dt.15.12.2017; vërtetimi i punësimi i dt.30.04.2021; Ankesa e dt.27.01.2021; Formuari i dt.27.01.2021; përgjigja ne ankese 13.08.2021; Kërkesa për përgjigje e dt.02.08.2021; Kontrata e punës 11.09.2015; përshkrimi i detyrave 01.06.2015; e-maili i dt.22.07.2021; njoftimi uidt.23.07.2021; e-maili i dt.22.04.2021; vërtetimi idt.30.04.2021; Aktgjykimi i dt.24.05.2023 numër 1485/2021; Aktgjykimi i dt.06.12.2022 numër C.nr.923/2021; vlerësimi i performancës – për vlerësimin e rezultateve ne pune i dt.12.01.2023.

Gjykata vlerësoi ligjshmërinë e vendimit të kontestuar në përputhje me nenin 44 të Ligjit për Konfliktet Administrative dhe provat e administruara në seancën e shqyrtimit kryesor, pretendimeve të palëve ndërgjyqëse, thënieve në padi dhe përgjigjen në padi të të paditurës dhe deklarimeve në seancën e shqyrtimit kryesor dhe pas shqyrtimit të gjitha shkresave tjera të lëndës së kësaj çështje administrative, konstatoi se padia e paditësit është e **bazuar**.

Me vendimin e Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës me numër A.nr.693/2021 të datës 05.08.2022 është refuzuar si e pa bazuar ankesa e datës 27.07.2021 e ankuesit, këtu paditësit

Paditësi i pakënaqur me vendimin kontestues të të paditurit, ka ushtruar padi në këtë gjykatë me datë 31.08.2022, duke e kontestuar ligjshmërinë e të njëjtit.

Gjykata për të shqyrtuar ligjshmërinë e aktit të kontestuar ju është referuar Ligjit nr. 03/L-149 për Shërbimin Civil të Kosovës, respektivisht nenit 3 paragrafi 5 i cili përcakton se: “ Personeli civil i punësuar në Policinë e Kosovës, në Forcën e Sigurisë së Kosovës, në Doganat e Kosovës, në Shërbimin Korrektues të Kosovës, është pjesë e shërbimit civil të Kosovës dhe i nënshtrohet këtij ligji dhe legjislacionit përkatës në fuqi”.

Me datë 14.11.2018 ka hy në fuqi Udhëzimi Administrativ Nr.02/2018 mbi Marrëdhënien e Punës në Policinë e Kosovës, ku në nenin 3 të këtij Udhëzimi përcaktohet se:” Personeli policor - nënkupton personelin e Policisë së Republikës së Kosovës: zyrtarët policorë, stafin civil dhe kadetët policorë”.

Ndërsa me nenin 44 par.1 dhe 2 të Ligjit Nr.04/L-076 për Policinë është përcaktuar se:” 1. Policia e Republikës së Kosovës punëson tri kategori të personelit policor: 1.1. zyrtarë policorë që bëjnë betimin dhe kanë autoritet t’i ushtrojnë dhe t’i kryejnë autorizimet dhe detyrat policore; 1.2. staf civil që punësohet për të kryer shërbime mbështetëse dhe administrative, por që nuk ka autoritet të ushtroj autorizime policore; 1.3. kadet policor”. Bazuar në dispozitat e lartcekura këtu paditësi, është pjesë e personelit policor të punësuar në Policinë e Kosovës.

Me nenin 29 paragrafi 2 i Udhëzimit Administrativ Nr.02/2018 mbi Marrëdhënien e Punës në Policinë e Kosovës përcaktohet se:”Personelit të Policisë të cilët kanë marrë vlerësim të kënaqshëm dhe të cilët nuk kanë qenë subjekt i shqiptimit të ndonjë mase disiplinore brenda vitit përkatës, do të përfitojnë si shpërblim një pagë mujore ekuivalente me pagën e rregullt mujore në fund të vitit. Shtesat në pagë për kualifikimin shkollor janë si në vijim: 3.1. diplomë universitare, (bachelor, fakulteti) 0.5%; 3.2.master, magjistër i shkencave, 1%; 3.3.doktoratë, PhD 2%. Për çdo vit të përvojës së punës, personeli policor ka të drejtë në shtesë mbi pagë në 0.5% të pagës për një vit. Personeli policor që është në marrëdhënie të vazhdueshme pune në Policinë e Kosovës iu takon shpërblimi në vlerë prej 25% të pagës mesatare në Policinë e Kosovës pas çdo dhjetë (10) vite pune (paga jubilarë)”.

Gjykata, vlerësoi se në këtë rast duhet të zbatohen dispozitat e Udhëzimit Administrativ nr. 02/2018 mbi Marrëdhënien e Punës në Policinë e Kosovës, për kërkesën e aprovuar të paditësit, që ka të bëjë me kompensimin e pagës së 13, për vitet 2018, 2019, 2020, 2021 dhe 2022 dhe për shtesën në pagë për kualifikim shkollorë për diplomë universitare prej 0.5%, për periudhën kohore për vitet 2018, 2019, 2020, 2021 dhe 2022 sipas pagës mujore prej 444.08 euro në muaj për (5) vite.

Në bazë të dispozitave të lartcekura të Udhëzimit Administrativ Nr. 02/2018 të nxjerr nga e paditura-punëdhënësi dhe shqyrtimit të shkresave të lëndës, gjykata erdhi në përfundim se kërkesëpadia e paditësit është e bazuar, sepse paditësi e gëzon të drejtën që në fund të çdo viti kalendarik ta përfitojë si shpërblim një pagë mujore, e cila do të jetë ekuivalente me pagën mujore

në fund të vitit kalendarik përkatës, nëse atë vit kalendarik punonjësit e të paditurës, në këtë rast paditësi, të kenë vlerësim të kënaqshëm të performancës së punës, të mos i jetë shqiptuar ndonjë

masë disiplinore brenda vitit përkatës. Në bazë të provave që gjenden në shkresat e lëndës, respektivisht Formularëve për vlerësimin e rezultateve në punë, gjykata konstaton se paditësi vazhdimisht ka marrë vlerësime të kënaqshme në punë nga ana e eprorit të tij (me vlerësim maksimal) gjë që dëshmohet edhe nga formularët e vlerësimit të performancës, si dhe paditësi asnjëherë nuk i është shqiptuar ndonjë masë disiplinore. Për më tepër e paditura nuk ka paraqitur ndonjë vërejtje, me anë të përgjigjes në padi, që do të vinte në dyshim performancën e paditësit për vitet e lartcekura, e po ashtu nga e paditura nuk është ngritur as çështja e ndonjë mase disiplinore eventuale të shqiptuar ndaj paditësit. Paga mujore e paditësit është në shumën prej 444.08 Euro bruto, ndërsa duke llogaritur për pesë vite, shuma e përgjithshme i bie të jetë në lartësi prej 2.220,4 Euro.

Po ashtu, sipas dispozitave të lartcekura, rezulton që paditësi e gëzon të drejtën për shtesë në pagë që në bazë të nenit të lartcekur, është 0.5%, në emër të kualifikimit shkollor për diplomën universitare “Bachelor i Arteve në Menaxhment dhe Informatikë”, sepse i njëjti e posedon Diplomën universitare të fituar në Kolegjin “Iliria” në Prishtinë me datën 15.12.2017. Andaj, duke pasur parasysh faktin që paditësi ka pagën mujore në shumë prej 444.08 euro €, gjykata vendosi se të njëjtit i takon shtesa e kërkuar në emër të kualifikimit shkollor për vitet 2018, 2019, 2020, 2021 dhe 2022 sipas pagës mujore prej 444.08 euro në muaj për (5) vite me 0.5%.

I autorizuari i paditësit në seancën mbi shqyrtimin kryesor ka deklaruar se heq dorë nga pjesa e kërkesëpadisë për shujtat ditore për vitet 2018-2019-2020 dhe 2021.

Prandaj për faktin se paditësi ka ofruar dëshmi të mjaftueshme për njohjen e kësaj të drejte dhe duke u bazuar në dispozitat e lartcekura, gjykata kërkesëpadinë e tij e aprovoi si të bazuar dhe si rrjedhojë e detyroi të paditurën si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Gjykata i vlerësoi edhe pretendimet e të paditurës Ministria e Punëve të Brendshme – Drejtoria e Përgjithshme e Policisë të dhëna në Njoftimin e datës 23.07.2021, ku gjeti se të njëjtat janë të pabazuara, për faktin se e paditura me asnjë provë shkresore-analizë buxhetore, nuk e argumenton faktin se ka mungesë të mjeteve buxhetore për përmbushjen e detyrimeve siç ka kërkuar paditësi, për pjesën e aprovuar të kërkesës.

Lidhur me kamatën ligjore, gjykata vendosi në kuptim të nenit 382 par.1 dhe 2 të Ligjit Nr.04/L-077 për Marrëdhëniet e Detyrimeve, kjo në bazë të nenit 63 të LKA-së, ku përcaktohet se, dispozitat e LPK-së do të zbatohen përshtatshëmrisht në rastet kur LKA nuk përmban dispozita për procedurën në konfliktet administrative.

Në bazë të asaj që u tha më lartë e në kuptim të nenit 2, 3, 4, 5, 6, 38, 43, paragrafit 3, nenit 46, të Ligjit për Konfliktet Administrative, vendosi si në dispozitiv të këtij Aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË
Departamenti për Çështje Administrative
A.nr. 2112/2022 datë 15.04.2024

Bashkëpunëtore profesionale
Donjeta Nikolla

G j y q t a r e
Luljeta Maxhuni

Këshillë Juridike: Kundër këtij aktgjykimi është e lejuar ankesa, në afat prej 15 ditësh, nga dita e marrjes së të njëjtit, në Gjykatën e Apelit në Prishtinë, përmes kësaj gjykate.